

VENDIM PËR TËRHEQJEN E PEZULLIMIT TË PJESSHËM TË AKREDITIMIT
Nr: 02/2019

Subjekti	“Kosova-Lab” Sh.A.
Adresa:	Graçanicë, Çagllavicë
Fusha:	Laboratori për analiza të naftës dhe derivateve të lëngëta të naftës

Bazuar në nenin 22 të Ligjit nr. 05/L-117 për Akreditim, kërkesat e standardit EN ISO/IEC 17011/2004, Procedurës për akreditim DAK-PT-01, procedurës për ankesa DAK-PT-03, si dhe raportit të komisionit për shqyrtimin e ankesave të datës 27/11/2019, Drejtorja e Përgjithshme e DAK-së, merr:

VENDIM

- I. **Shfuqizohet vendimi nr.01/2019** i datës 05.08.2019 i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës për pezullim të akreditimit për metodën e matjes së shtypjes së avullit për laboratorin “Kosova-Lab” Sh.A.

ARSYETIM

Me datën 04.11.2019 DAK ka pranuar kopjen e certifikatës së ri-kalibrimit të pajisjes për matjen e shtypjes së avullit nga laboratori i akredituar Kosova-Lab. Ky dokument u shqyrtua nga anëtarët e ekipit të cilët pas realizimit të një mbikëqyrje të jashtëzakonshme, që rezultoi me gjetje, i kishin dhënë rekomandim Drejtores së DAK-së e cila pastaj bazuar në këtë raport ka nxjerre vendimin nr. 01/2019 të datës 05.08.2019 për pezullim të akreditimit të laboratorit Kosova-Lab Sh.A. për metodën e matjes së shtypjes së avullit, deri në dorëzimin e dëshmimeve për ri-kalibrimin e pajisjes përkatëse me CRM-të përkatëse në tri pika vlerat e të cilave janë të përafërta me tri pikat kufitare (minimale/maksimale) të përcaktuara në UA 01/2017 Për Cilësinë e Karburantëve të Lëngëta të Naftës për katër stinët e ndryshme në Kosovë, respektivisht të përafërta me vlerat 45, 60, dhe 90 kPa. Pas shqyrtimit të dokumentit në fjale, ekipi i mbikëqyrjes ka vlerësuar se laboratori Kosova-Lab i ka permbushur kërkesat e përcaktuara në vendimin 01/2019 dhe me raportin e dates 27.11.2019 i ka rekomanduar Drejtores së DAK-së shfuqizimin e këtij vendimi.

Prishtinë: 29/11/2019

Drejtorja e Përgjithshme e DAK-së
Gentiana Islamaj